



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 15/3 datë 30/12/1996

**PER
NDERRIM EMRI OSE MBIEMRI.**

Këshilli i Bashkisë së Tiranës në mbledhjen e tij të dt.14.02.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Gjendjes Civile “Për ndërrim Emri ose Mbiemri”, sipas kërkesave të qytetarëve, në mbështetje të Ligjit Nr.5840, neni.21, dt.20.02.1979, i ndryshuar me ligjin Nr.7652, dt.09.03.1993 “Për rregjistrimin e akteve të gjendjes civile” :

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e emrave ose të mbiemrave sipas disa kriterëve :
 - 1.Emrat ose Mbiemrat që ndryshojnë me një gërmë, si dhe shkurtime.
 - 2.Mbiemri i vajzërisë ose i bashkëshortit(seksi femër).
 - 3.Emrat – Mbiemrat përçmues.
 - 4.Emrat – Mbiemrat kur ka vendim gjyqi, kur ka dokumentacion zyrtar – administrativ.
 - 5.Kur janë fëmijë të birësuar, fëmijë të mitur.
 - 6.Uniformiteti i Mbiemrit në familje.
 - 7.Për interesa të rëndësishme.

- 8.Si rregull vetëm një herë.
2. Ti propozojë Sekretarit të Pushtetit Lokal që ti drejtohet Ministrisë së Drejtësisë (Zyrës së Gjendjes Civile), për të vendosur në lidhje me kriteret e mësipërme, të cilatdo ti shërbejnë Këshillt për punën e tij në lidhje me ndryshimin e emrave ose mbiemrave.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI